UDC: 811.133.1’373.2:59]:398.91(=133.1)
UDC: 811.18’373.2:59]:398.91(=18)
Original scientific paper

ANIMAL NAMES IN FRENCH AND ALBANIAN PROVERBS
EMRAT E KAFSHËVE NË PROVERBAT FRANCEZE DHE SHQIPTARE

Shejnaze AJDINI-MURTEZI[1]

[1*] *Institute of Spiritual and Cultural Heritage of the Albanians – Skopje*
[*]*Corresponding author e-mail: sheajdini@hotmail.com*

Abstract

The aim of this paper is to analyze French and Albanian proverbs which contain animal names. By highlighting the similarities and differences from a cultural standpoint, we will try to find the equivalences between them. On this occasion, we have compared the presence of animal names in selected proverbs in order to ascertain whether the same domestic and wild animals have been perceived in the same way in both cultures, as well as if their metaphorical and symbolic meaning is the same.

With the help of the contrasting method, we will analyze the lexical and semantic structure of French proverbs which contain these lexemes and their Albanian equivalents. We have divided these proverbs into two categories: those which have the same lexico-semantic structure in both languages and those that have different lexical structures, whereas, based on their semantic content are the same.

Keywords: *proverbs, animals, equivalences, cultures, lexico-semantic.*

Përmbledhje

Qëllimi i këtij punimi është analiza e proverbave franceze dhe shqiptare të cilat përmbajnë emra të kafshëve. Duke i vënë në pah ngjashmëritë dhe dallimet në aspektin kulturor, do të përpiqemi t’i gjejmë ekuivalencat midis tyre. Me këtë rast, e kemi krahasuar praninë e emrave të kafshëve në proverbat e zgjedhura me qëllim që të konstatojmë nëse të njëjtat kafshë shtëpiake dhe kafshë të egra janë parë në të njëjtën mënyrë në të dy kulturat, ashtu si edhe nëse kuptimi i tyre metaforik e simbolik është i njëjtë.

Me ndihmën e metodës kontrastive do ta analizojmë strukturën leksikore dhe semantike të proverbave franceze të cilat i përmbajnë këto leksema dhe ekuivalentet e tyre shqiptare. Këto proverba i kemi ndarë në dy kategori: ato të cilat kanë strukturë të njëjtë leksiko-semantike në të dy gjuhët dhe ato që kanë strukturë të ndryshme leksikore, ndërsa për nga përmbajtja semantike janë të njëjta.

Fjalët kyçe: *proverbat, kafshët, ekuivalencat, kulturat, leksiko-semantike.*

1. Hyrje

Proverbi si një fjali e ngurtësuar është i pranishëm në të gjitha kulturat botërore. Ai paraqet një trashëgimi të rëndësishme në fushën gjuhësore e kulturore si për gjuhën frënge ashtu edhe për gjuhën shqipe. Në fushën e paremiologjisë kontrastive, një ndër pengesat që duhet tejkaluar është gjetja e ekuivalencave paremiologjike. Pikërisht, për këtë arsye, në kuadër të këtij studimi, ne kemi zgjedhur të bëjmë krahasimin e proverbave franceze dhe shqiptare të cilat përmbajnë emra të kafshëve, bazuar në korpusin tonë të cilin e kemi formuar duke nxjerrë shembuj nga fjalorë dhe artikuj si në gjuhën frënge ashtu edhe në gjuhën shqipe, por edhe duke i marrë parasysh proverbat që kanë frekuencë më të madhe në përditshmërinë tonë.

Këto proverba janë analizuar në kuadër të gjuhësisë konjitive më qëllim që të tregohet se në çfarë niveli përvoja jonë dhe njohja e disa koncepteve themelore na ndihmon të kuptojmë koncepte abstrakte me ndihmën e metaforës. Proverbat në fjalë i kemi ndarë në dy kategori: ato që kanë strukturë të njëjtë leksikore dhe kuptim të njëjtë dhe ato që kanë strukturë të ndryshme leksikore, por kuptim të njëjtë, që do të thotë se përdoren në situata të njëjta.

Për të përcaktuar më mirë këtë hulumtim, në fillim do të rikujtojmë shkurtimisht historinë dhe aktualitetin e proverbave franceze dhe shqiptare. Në vijim do të përshkruajmë karakteristikat e proverbave duke u përqëndruar në karakterin e ngurtësuar të tyre. Meqë bëhet fjalë për proverba të cilat përmbajnë emra të kafshëve, është më se e nevojshme që të flasim për cilësitë dhe të metat e kafshëve të cilat barten te njerëzit nëpërmjet karakterit të tyre figurativ. Krejt në fund, me anë të metodës kontrastive do t'i analizojmë përkimet leksikore dhe semantike të proverbave përkatëse me qëllim që të vihen në pah ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet tyre, përkatësisht ekuivalencat leksikore të plota, por edhe ato të pjesshme dhe dallimet leksikore.

2. Qasje teorike, korpusi dhe metodat

Proverbi si një fjali e ngurtësuar është i pranishëm në të gjitha kulturat botërore. Shumë linguistë si Kleiber (1999), Arnaud (1991, 1992), Anscombre (1994), Michaux (1999) e të tjerë kanë konstatuar se pëkufizimi i proverbit nuk është një punë e lehtë, përshkak se dallimet në mes tij dhe llojeve të ngjashme si thëniet, maksimat, aforizmat etj,. janë mjaft delikate. Kjo punë vështirësohet edhe më tepër, sidomos, kur bëhet fjalë për krahasimin e proverbave të dy a më shumë gjuhëve e kulturave, largësia gjuhësore e semantike e të cilave është e pakontesueshme.

Në dritën e studimeve mbi këtë temë, ne mund ta dallojmë proverbin nga llojet e tjera të fjalive të ngurtësura duke u bazuar në veçoritë si: metaforike, kolektive, popullore, anonime etj. Pra, para së gjithash, proverbi është një lloj fjalie, i cili karakterizohet me mungesën e plotë të kumtuesit dhe me formën e tij të shkurtër. Ai është një paremi me tematikë të përgjithshme, me një kuptim idiomatik, me një strukturë përgjithësisht binare. Nëpërmjet tij pasqyrohet tradita, kultura dhe përvoja jetësore e një shoqërie. Ai bart gjithnjë një urtësi duke trajtuar tema të ndryshme si miqësinë, dashurinë, shëndetin, paranë, veset dhe cilësitë e njerëzve.

Gjuhëtari francez, Michel Ballard, na ofron një përkufizim thelbësor të proverbit, duke bërë një sintezë të përkufizimeve të dhëna nga autorët tjerë: „Proverbi është një thënie e ngurtësuar plotësisht që synon të transmetojë një të vërtetë nga përvoja apo një këshillë nga urtësia popullore; ai bën pjesë në kujtesën kolektive të një komuniteti gjuhësor (apo në një nga nëngrupet e tij) dhe paraqitet si një trashëgimi popullore apo stërgjyshore; ai paraqitet me një formulë shpesh koncize, pak a shumë eliptike dhe përgjithësisht pitoreske; për shembull: The more, the merrier" (Ballard, 2009, 38).[32]

[32] *Le proverbe est un énoncé figé complet visant à transmettre une vérité d'expérience ou un conseil de sagesse pratique; il fait partie de la mémoire collective d'une communité linguistique (oud'un de ses sous-groupes) et se*

Proverbi paraqet një trashëgimi të rëndësishme në fushën gjuhësore e kulturore si për gjuhën frënge ashtu edhe për gjuhën shqipe. Gjuhëtarët dhe teoriticientët francezë si Greimas, Anscombre, Kleiber e të tjerë, ia kanë kushtuar një numër të madh kërkimesh studimit të këso lloj fjalish. Studimet e tyre janë të shumta dhe të llojlloshme, si në aspektin gjuhësor, ashtu edhe në atë semantik e retorik. Të gjitha këto studime kanë për qëllim të tregojnë se ky lloj letrar meriton t'i kushtohet një vëmendje e rëndësishme në fushën e kërkimeve shkencore.

Studimin e proverbave shqiptare ndër të parët e ka filluar paremiografi ynë, Frang Bardhi, i cili në fjalorin e tij *Dictionarium Latino Epiroticum*, botuar në vitin 1635, përveç tjerash ka bërë edhe krahasimin e disa proverbave shqipe me ato latine dhe turke. Pa mos i përmendur edhe paremiologët e shumtë shqiptarë pas kësaj periudhe që kanë dhënë kontributin e tyre në këtë fushë, është me interes për punimin tonë të përmendim edhe Kolë Kamsin, i cili në vëllimin e tij Goja e popullit t'onë, botuar në vitin, 1943, përveç tjerash, bën krahasimin e proverbave shqiptare me ato të huajat. Me mbledhjen e proverbave u morën edhe gjuhëtarë të tjerë, si Kamarda, Xhuvani, Çeta, Halimi, Tuda e shumë të tjerë në vazhdimësi.

Në traditën shqiptare termat proverba dhe fjalë të urta shpeshherë përdoren me kuptime sinonimike, por edhe me dy kuptime të ndryshme, varësisht prej literaturës shkencore që përdoret nga studiuesit. Shpeshherë për të njëjtën dukuri mund të hasen vlerësime të ndryshme, madje edhe të kundërta. Kjo vjen nga fakti se proverbat, duke ardhur nga tradita gojore dhe duke funksionuar në mënyrë auditive, janë krijuar nga njerëz të shtresave të ndryshme shoqërore dhe në to, nganjëherë, është vështirë të shmangen ndryshimet. Për këtë term, në traditën shqiptare përdoren emërtime të ndryshme: fjalë (ose thënie) të urta, fjalë ari, fjalë të moçme (ose të lashta), fjalë të mençme, fjalë plaka (Panajoti & Xhagolli, 1987, 10-11).

Sa i përket përkufizimit të proverbave mund t'i përmendim disa sosh. Sipas Anton Çetës „provebat e paraqesin jetën në mënyrë objektive. Ato janë shprehje letraro-filozofike, relativisht të pavarura" (Çeta, 1979, 30). Ndërsa, Rahmi Tuda i përkufizon proverbat si „thënie të shkurtra, të dendura, metaforike, që shprehin përvojën shekullore të shumë brezave si dhe aspekte me përmbajtje të plotë dhe të thellë. Në to paraqitet përvoja e breznive, shfaqen vrojtime, meditime, qëndrime mbi çështje të ndryshme, mbi ngjarje, dukuri të natyrës, të shoqërisë dhe të jetës njerëzore" (Tuda, 1995, 21).

Një numër të madh të proverbave që përfshihet në materialin paremiologjik shqiptar haset edhe te popujt tjerë. Këto lloj proverbash shquhen për nga porosia proverbiale e njëjtë. Është mjaft e vështirë, madje në disa raste edhe e pamundur të përcaktohet origjina dhe përkatësia e tyre. Supozohet se shkaku i shfaqjes së një dukurie të tillë të jenë rrethanat shoqëroro-ekonomike, historike e kulturore, në mos të njëjta, të paktën të ngjashme të cilat kushtëzojnë edhe krijimtari shpirtërore me porosi të njëjta.

Proverbat që kanë karakter ndërkombëtar, trajtojnë çështje të jetës së njeriut, të së vërtetës e të gënjeshtrës, të dijes e të padijes, të së mirës dhe të keqes, të vyrtytit dhe të vesit, të dashurisë dhe të mërisë, çështje të moralit njerëzor, dukuri të natyrës etj. Specifikat e këtyre proverbave janë: porosia morale, mesazhi i njëjtë proverbial, struktura e ngjashme apo identike e formës e sidomos ato i shquan ideja e përgjithshme, pa marrë parasysh se në cilën gjuhë shkruhen. Këto lloj të trajtave të dendura janë bërë pjesë e vetëdijes, e kulturës shpirtërore dhe janë kombëtare aq sa janë edhe ndërkombëtare dhe anasjelltas (Tuda, 1995, 24).

Sa i përket qasjes teorike, hulumtimi ynë është bazuar në teorinë e prototipeve, si edhe në fushën dhe njohuritë e linguistikës konjitive, sidomos në metaforën konceptuale. Gjuhësia konjitive e vendos metaforën në vetë procesin e të menduarit në të cilin ajo shfaqet si një nga parimet organizuese të sistemit konceptual njerëzor.

---

présente comme un héritage de la sagesse populaire ou ancestrale; il est exprimé en une formule souvent lapidaire, plus ou moins elliptique et généralement imagée; par exemple: The more, the merrier (Plus on est de fous, plus on rit - Sa më të marrë të jemi, aq më shumë qeshim).

Sipas kësaj qasje, metafora është përkufizuar si «të kuptuarit e një koncepti apo fushe konceptuale duke përdorur një koncept tjetër apo një fushë tjetër konceptuale». Teoria Konceptuale e Metaforës, shkurt CMT (Conceptual Metafora Theory) u përhap gjerësisht dhe u ripunua pas botimit të veprës Metafors We Live By të autorëve Lakoff dhe Johnson në vitin 1980. Kjo vepër mundësoi që kërkimet në fushën e semantikës konjitive të lulëzojnë, po megjithatë debatet për shumë çështje të kësaj fushe ende vazhdojnë. Sipas kësaj teorie, ndryshe nga idetë tradicionale të pranuara deri më tani, metaforat nuk janë ekskluzivisht dekorative, por përkundrazi ato luajnë një rol qendror dhe të domosdoshëm si në mendimet tona ashtu edhe në gjuhë (Deignan, 2005, 4).

Lakoff-i dhe Johnson-i deklarojnë se ne jetojmë me metafora gjatë gjithë kohës dhe se ato udhëheqin me mënyrën tonë të të menduarit dhe të perceptuarit të botës. Ata pretendojnë se vetë procesi i të menduarit është kryesisht metaforik dhe përmbledhtas shprehen se „vetë thelbi i metaforës është të kuptosh dhe të përjetosh një gjë në kuptim të diçkaje tjetër“ (Lakoff & Johson, 2003, 5). Sipas Yvon Keromnes, teoria e metaforës konceptuale propozon një model të raportit midis gjuhës dhe të menduarit të tillë që paraqitjet konceptuale dhe gjuhësore të jenë të dallueshme në mënyrë që këto të fundit të mund të na informojë për të parat. Është e vështirë të mendosh pa këto metafora, ashtu që edhe në rastin kur flitet për lënien mënjanë të metaforave për të parë më qartë, jemi ende në metaforë (Keromnes, 2013, 68-87).

Për t'i analizuar proverbat franceze që përmbajnë emra të kafshëve dhe ekuivalentet e tyre shqiptare, në studimin tonë, kemi përdorur metodën komparative dhe kontrastive duke i vënë në pah ngjashmëritë dhe dallimet leksiko-semantike që ekzistojnë ndërmjet tyre. Korpusin tonë e kemi themeluar nga proverba të nxjerra prej disa burimeve - fjalorë paremiologjikë dhe përmbledhje të proverbave. Sa i përket korpusit francez, jemi bazuar kryesisht në fjalorët e proverbave dhe thënieve të F. Motreynaud, A. Pierron et F. Suzzoni si edhe në përmbledhjet e proverbave të R. De Lincy, de M. Maloux.

Ndërsa, korpusi shqiptar, ku i kemi gjetur proverbat ekuivalente përbëhet nga përmbledhje të proverbave të Destan Bajraktarit, Anton Çetës, Rami Tudës, Mehmet Gjevori, si edhe proverba që kanë frekuencë më të madhe në përditshmërinë tonë. Sa i përket proverbave shqipe duhet të theksojmë se i kemi dhënë në origjinal, pra nga të folmet e regjioneve shqiptare, pa pretenduar ta japim edhe versionin në gjuhën standarde. Duke u nisur nga referencat e përmendura, ne kemi analizuar dymbëdhjetë proverba të cilat përmbajnë emra të kafshëve. Pesë prej tyre kanë strukturë të njëjtë leksiko-semantike, ndërsa shtatë strukturë të ndryshme leksikore, por përmbajtje të njëjtë semantike.

Te shumë popuj gjejmë proverba që janë ekuivalente midis tyre, por më të shumta janë proverbat që nuk janë ekuivalentë për nga mjetet e shprehjes së proverbialitetit parabolik. Ajo çka është universale rreth proverbave është mekanizmi konjitiv njohës që folësit e përdorin me qëllim që të prodhojnë, të kuptojnë dhe të transmetojnë. Duhet të theksojmë se proverbat, e sidomos ato me emra të kafshëve, mbeten përdorimi më i përpunuar për ta kuptuar natyrën njerëzore.

3. Të metat dhe cilësitë e kafshëve të bartura te njerëzit

Kafshët përbëjnë një pjesë të rëndësishme të natyrës. Ekzistimi i proverbave të shumta që përmbajnë emra të kafshëve, padyshim se arsyetohet me faktin se ato ishin të gjithëpranishme në jetën e njeriut, sidomos deri në fillim të shekullit XX (por aty-këtu edhe në ditët e sotme), kur popullsia kryesisht ishte rurale dhe jetonte në një mjedis të populluar me lloje të kafshëve të cilat i nevojiteshin (delet, lopët, kuajt, …), por gjithashtu edhe me lloje me të cilat ishte e detyruar t'i ndante burimet e saja (qentë, macat, minjtë, ...) apo edhe me ato me të cilat duhej, pa dashje, t'i pranonte në universin e saj (ariun, ujkun, dhelprën, ...).

Përmendëm edhe më lart se një nga veçoritë kryesore të proverbit është kuptimi figurativ i tij. Mbi të gjitha figurat e shprehjes artistike me të madhe përdoret metafora. Përmes kuptimit të bartur proverbi shpreh ide, pikëpamje dhe i vë në dukje vyrtytet dhe të metat e njerëzve. Kështu, si kulturën franceze ashtu edhe në atë shqiptare dhelpra personifikon njeriun dinak, lepuri përshkruhet si i shpejtë, por edhe frikacak, gomari personifikon njeriun kokëtrash, luani përshkruhet si i guximshëm, i fortë, gjuetar, ujku simbolizon gjakpirësin, tradhëtarin, mizorin, ndërsa qeni përshkruhet si grindavec, i tërbuar, por njëkohësisht i ndjeshëm dhe besnik për dallim nga macja e cila përgjithësisht simbolizon butësinë. Sigurisht se kur dikujt i thuhet: ujk, dhelpër, luan, a lepur, breshkë etj., nuk mendohet në kuptimin e parë të këtyre emrave, por në kuptimin e bartur. Pra, me emrat e shtazëve, të shpezëve, të gjërave, të objekteve, të fenomeneve e të nocioneve abstrakte nënkuptojmë njerëzit me atribute jo të natyrshme të tyre.

3.1. Ekuivalenca leksikore e semantike

Proverbi i gjuhës së synuar (gjuhës shqipe) është formuar nga të njëjtat njësi leksikore, ka të njëjtin kuptim dhe mund të përdoret në situata të njëjta si edhe proverbi i gjuhës burimore (gjuhës frënge). Pra, të dy gjuhët përdorin të njëjtën kafshë për të shprehur një ide. Ja disa nga shembujt e analizuar:

- *Chien qui aboie ne mord pas* - kuptimi: Nuk duhet të kemi frikë nga një person që bërtet shumë. Në gjuhën shqipe thuhet njësoj: *«Qeni që leh shumë nuk ha»*.

- *Quand on parle du loup, on en voit la queue* - kuptimi: Kur flasim për një njeri të dyshimtë apo për çfarëdo qoftë njeriu, ai paraqitet (shfaqet)). Në gjuhën shqipe thuhet: *«Fol për ujkun, ujku pas dere»*.

- *Le loup change de poil, mais non de naturel* - kuptimi: Se ujku mund ta ndryshojë lëkurën, por nuk mund natyrën e tij, përkatësisht shprehitë e tij, ashtu siç nuk mund të ndryshojë thellësisht as njeriu keqbërës, i djallëzuar e me shprehi të këqija. Në gjuhën shqipe thuhet : *«Ujku qimen e ndërron, po zanatin s'e harron »*.

- *Quand le chat n'est pas là, les souris dansent* - kuptimi: Kur udhëheqësi mungon, ata që varen prej tij, përfitojnë nga kjo situatë. Në shqip thuhet: *«Kur macja nuk është në shtëpi, minjtë bëjnë dasëm»* apo *«Kur ikën macja luajnë minjtë »*.

-*À cheval donné, on ne regarde pas les dents/la bouche* - kuptimi: Kur pranojmë ndonjë dhuratë. duhet ta çmojmë dhe të jemi falënderues, pa marrë parasysh vlerën e saj materiale Proverba ekuivalente shqiptare është: *«Kalit t'falun nuk i kqyren dhamët»* (Çeta, 1979, 253).

3.2. Strukturë të ndryshme leksikore, por domethënie të njëjtë semantike

Përkundër ngjashmërive te proverbat franceze dhe shqiptare, gjatë bartjes së kuptimit, përkatësisht gjatë bartjes së të metave dhe cilësive nga kafshët te njeriu, ekzistojnë edhe mjaft dallime. Në rastin kur përkthimi i fjalëpërfjalshëm nga gjuha burimore në atë të synuarën nuk është i mundur, përkthyesi apo përdoruesi mund ta zbatojë përkthimin komunikativ, duke përkthyer një proverb me një proverb tjetër, të formuar që të dy nga njësi të ndryshme leksikore, por që mund të përdoren në situata të njëjta. Në këtë rast kemi:

a) Kafshë e zëvendësuar me një kafshë tjetër

Proverbat franceze në vijim kanë ekuivalentet e tyre me të njëjtin kuptim apo të ngjashëm, por përdorin kafshë të tjera.

- *Mieux vaut promptement un œuf que demain un bœuf* - kuptimi: Më mirë është të marrim atë që na ofrohet sot, qoftë edhe pak, po që është më e sigurtë se të presim ndoshta edhe për një kohë të pacaktur për të marrë më shumë, e që në fakt nuk është e sigurtë. Proverbi ekuivalent në shqip është: *«Më mirë një vezë sot, se një pulë mot»*.

- *C'est le nid d'une souris dans l'oreille d'un chat* - kuptimi : Se një gjë është e pamundur ose një situatë e rrezikshme. Në gjuhën shqipe, për të shprehur idenë e njëjtë, pra, idenë për gjërat e pamundshme, përdoret logjika e njëjtë: *«Kur gjeli t'bën vezë»*.

- *Qui ne peut battre le cheval, batte la selle ou le bast* - kuptimi: Kur nuk kemi guxim t'ia shprehim mllefin atij që na ka hidhëruar ose na ka bërë padrejtësi, por i vërsulemi dikujt që është i pafajshëm. Proverbi ekuivalent në shqip është: *«N'ven se m'i mshue magarit, aj p'i mshon samarit»* (Bajraktari, 1994, 370).

b) Kafshë e zëvendësuar me një simbol tjetër

- *Chat échaudé craint l'eau froide* - kuptimi : Çdo përvojë e hidhur duhet të na shërbejë si mësim për të pasur kujdes në veprimet tona. Në gjuhën shqipe përdoret proverbi i cili nuk përmban emër kafsheh, por është zëvendësuar me një simbol tjetër: « *I dogj tamli, i fryn kosit* (Çeta, 1979, 252).

- *On prend plus de mouches avec du miel qu'avec du vinaigre* - kuptimi : Kur flasim ëmbël e ngadalë me dikë, kemi më shumë gjasa dhe përparësi të kemi sukses se sa kur përdorim fjalë të ashpra. Këtij proverbi në shqip i përgjigjet proverbi prej të cilit mund të nxjerret e njëjta urtësi: *«Fjala e ëmbël i hap dyert e hekurta»*.

- *Le chien à quatre pattes, mais il n'est pas capable de prendre quatre chemins* - kuptimi *:* Kush kërkon diçka që i kalon mundësitë e tija, mund të mbetet pa asgjë. Edhe pse proverbi në gjuhën shqipe për nga struktura leksikore është krejtësisht i ndryshëm nga ai i gjuës frënge, mund të themi se për nga ana kuptimore është i ngjashëm me të dhe mund të përdoret në situata të njëjta: *«Kush e lyp copën e madhe, jet pa tâ»* (Çeta, 1979, 255).

- *Bon chien chasse de race* - kuptimi: Thuhet në rastin kur fëmijët trashëgojnë cilësitë apo edhe të metat e prindërve të tyre. Për të shprehur idenë e njëjtë, sidomos kur trashëgohen cilësitë e familjes, në gjuhën shqipe kemi proverbin: *«Dardha bie ndër dardhë»*.

4. Përfundimi

Qëllimi i këtij punimi ishte që të vihen në pah ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet proverbave franceze dhe shqiptare për sa i përket formës dhe përmbajtjes së tyre. Gjatë analizës së proverbave në fjalë kemi vërejtur se dallimi midis tyre pasqyrohet më së shumti në përzgjedhjen e kafshëve të caktuara për të përshkuar disa aspekte të qenies njerëzore. Padyshim se ky dallim kushtëzohet nga kultura, tradita dhe simbolet prototipike.

Në aspektin e metaforës konceptuale, proverbat franceze dhe shqiptare shfaqin gjithashtu edhe mjaft përputhshmëri. Në të dy kulturat, hasim pothuajse simbolikën e njëjtë, si pozitive ashtu edhe negative në lidhje me kafshët. Nisur nga proverbat e marra si shembuj mund të thuhet se kafshët posedojnë kryesisht karakteristika negative të cilat nëpërmjet metaforës i referohen gjendjes shpirtërore të njeriut, karakterit dhe pozitës së tij në shoqëri.

Analiza e proverbave të cilat përmbajnë emra të kafshëve shtëpiake dhe të egra në gjuhën frënge dhe atë shqipe në kuadër të gjuhësisë konjitive mundëson të kuptojmë më mirë jo vetëm domethënien e dhënë të proverbave, por edhe parimet në bazë të të cilave ndërtohen ato.

Pavarësisht studimeve të shumta, mund të thuhet se përkufizimi i proverbit mbetet ende një problem i pazgjidhur përfundimisht. Pikërisht, për këtë arsye çdo gjuhëtar i cili përpiqet ta studiojë atë sipas qasjes dhe hipotezave të tij të zgjedhura, për mendimin tonë, duhet të përfshijë karakterin metaforik, i cili falë përbërësve të tij na mundëson që më lehtë të bëjmë analiza krahasuese. Përfundim i përgjithshëm i këtij kontributi modest është se, në këtë lloj sekuence, metafora është karakteristika kryesore e proverbit dhe një mjet i domosdoshëm për studime kontrastive.

Referencat

[1]. Ballard, M. (2009). *Le proverbe: approche traductologique réaliste*, Paris: L'Harmattan.
[2]. Bajraktari, D. (1994). *Fjalë të urta dhe thënie popullore shqipe*, Prishtinë.
[3]. Çeta, A. (1979). *Prozë popullore nga Drenica*, Prishtinë: Rilindja.
[4]. Deignan, A. (2005). *Metaphor and Corpus Linguistics.* Amsterdam/Philadelphia: John Benjamins Publication. http://site.ebrary.com/lib/UMEAUB/detail.action?docID=10081764 [konsultuar më 21/01/22].
[5]. Keromnes, Y. (2013). *Les Métaphores - et leur traduction - dans la vie quotidienne*, Revue SEPTET, Anagrammes, pp.68-87. hal-00944651.
[6]. Gjevori, M. (1972). *Frazeologjizma të gjuhës shqipe*. Prishtinë: Rilindja.
[7]. Lakoff, G. & Johson, M. (2003). *Metaphors We Live By*. Chicago: University of Chicago Press.
[8]. Lincy, R. (1996). *Le Livre des proverbes français.* Paris: Hachette littérature.
[9]. Maloux, M. (2006). *Dictionnaire des proverbes, sentences et maximes*, Paris: Larousse.
[10]. Montreynaud, F. et al. (2006). *Dictionnaire de proverbes et dictons*, Paris: Le Robert.
[11]. Panajoti, J. & Xhagolli, A. (1987). *Fjalë të urta shqipe*, Prishtinë: Rilindja.
[12].Tuda, R. (1995). *Çështje paremiologjike*, Tetovë: Bashkësi Kulturore Shqiptare.